



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ✓

Nr. 2731 Prot.

Tiranë, më 03/10/2025

Lënda: Kërkesë për zhvillimin e një mocioni me debat dhe për ngritjen e një Komisioni të Posaçëm të Kuvendit të Shqipërisë

Baza Ligjore: Neni 24 dhe 98 i Rregullores së Kuvendit

Drejtuar: Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë

Fondet e IPARD ndihmojnë bujqësinë shqiptare përmes financimit të projekteve të fermerëve shqiptar në sera të reja, agroturizëm, pika grumbullimit, traktorë e mjete të tjera mekanike. Këto fonde mundësojnë që bujqësia, blegtoria, peshkimi, akuakultura dhe zhvillimi rural të mund të zhvillohen në një mënyrë të qëndrueshme.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka ndjekur me shumë shqetësim gjetjet e OLAF, të cilat kanë sjell bllokimin e financimit të Bashkimit European për fermerët shqiptarë. Zyra e Bashkimit Evropian kundër Mashtrimeve, OLAF, njoftoi zyrtarisht se ka identifikuar keqpërdorimin e 33 milionë eurove fonde të BE-së në ndihmë të bujqësisë shqiptare dhe rekomandoi bllokimin e paketës së radhës prej 112 milionë euro, për sa kohë nuk ka masa për të garantuar mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

Në pasqyrën e punës për vitin 2023, OLAF ka zbuluar tre shkeljet kryesore që bëheshin me fondet IPARD II, të cilat që nga korriku 2023 janë pezulluar. Konkretisht, pas një sërë hapash komplekse hetimore, përfshirë shqyrtimin digjital të dokumenteve të lidhura me marrësit e IPARD II, AZHBR dhe operatorë të tjerë ekonomikë, OLAF zbuloi disa parregullsi serioze gjatë fazës së dhënies së granteve dhe zbatimit të disa projekteve. Këto parregullsi përfshinin:

1. Aplikantëve u kërkohet t'i paguajnë një pjesë të konsiderueshme të grantit të tyre një kompanie konsulence lokale;
2. Kontratat që jepen pa konkurrim, ose me konkurs të manipuluar (me oferta false që dorëzohen);
3. Çmime të fryra dhe shkelje të rregullave kontraktuale.

Pas hetimit të saj, OLAF i ka rekomanduar Komisionit Evropian që të konsiderojë një pjesë të financimit të Thirrjes së Parë dhe të Dytë për Aplikime IPARD II prej 33 milionë euro, si të papërshtatshme. Ndërkohë që ka rekomanduar gjithashtu që Bashkimi Evropian të ndalojë programin IPARD III me vlerë 112 milionë euro “deri sa të merren masa për të mbrojtur interesat financiare të BE-së nga aktivitetet ilegale”.

OLAF raporton se hetoi akuza serioze që përfshinin keqpërdorimin e fondeve të BE-së nga Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit për Zhvillimin Rural (IPARD II) në Shqipëri. Një praktikë abuzuese ishte se aplikantët për IPARD II ishin të detyruar të paguanin një përqindje të madhe të grantit të tyre për kompanitë e konsulencës të ‘përzgjedhura paraprakisht’, të cilat më pas do të lehtësonin kontratat me Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin Rural dhe Bujqësinë (AZHBR), e cila shpërndante fondet.

Për këtë arsye, për shkak të dyshimeve për korrupsion të institucioneve përgjegjëse të ekzekutivit, pasojat e këtij veprimi, i vuajnë me pa të drejtë fermerët shqiptarë.

Prandaj, duke pasur parasysh sa më lart, në mbështetje të nenit 98, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, kërkojmë zhvillimin e **një mocioni me debat** lidhur me gjetjet e OLAF dhe masat që duhet të marrë Kuvendi i Shqipërisë që të sigurohen mekanizmat e nevojshme që mbrojnë interesat financiare të BE-së nga aktivitetet ilegale dhe që sjellin përfitimin e fondeve nga programi IPARD nga fermerët shqiptarë.

Gjithashtu, në vlerësimin tonë është e nevojshme që Kuvendi i Shqipërisë të miratojë një **Rezolutë**, ku apelon institucionet e drejtësisë që të kryejnë një hetim të plotë dhe të shpejtë për të vënë përpara përgjegjësisë penale cilido që ka shkelur ligjin, si dhe merr anagzhimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore që të shmangen situata të kësaj natyre në të ardhmen dhe që mbrojnë interesat financiare të BE-së nga aktivitetet ilegale.

Konkretisht, draft Rezoluta, propozojmë që të përfshijnë përcaktimet si më poshtë:

Kuvendi i Shqipërisë:

1. I shpreh mirënjohjen Bashkimit Evropian për ndihmën e çmuar që ka dhënë në vazhdimësi për Shqipërinë, përmes programit të mbështetjes në bujqësi IPARD.
2. Dënon ashpër dhe distancohet nga abuzimet e pretenduara me fondet e taksapaguesve evropian dhe kërkon nga Këshilli i Ministrave që të ndërmarrë me urgjencë masa të brendshëm, për të evidentuar mangësitë dhe përgjegjësitë përkatëse administrative, si dhe për të siguruar kthimin e plotë të fondeve të shpërdoruara në

praktika abuzive dhe të dyshuara si korruptive. Rezultatet e këtyre masave të brendshëm administrative duhet ti njoftohen Kuvendit të Shqipërisë brenda 1 muaji nga miratimi i kësaj Rezolute.

3. Apelon institucionet e drejtësisë që të kryejnë një hetim të plotë, profesional dhe të shpejtë, për të vënë përpara përgjegjësisë penale cilido që ka shkelur ligjin, duke mbajtur në konsideratë edhe gjetjet e hetimeve të kryera nga Zyra e Bashkimit Evropian kundër Mashtrimeve (OLAF), që raportohet zyrtarisht që është vënë në dispozicion të autoriteteve shqiptare.

4. Merr anagzhimin për të miratuar të gjitha masat e nevojshme ligjore që të shmangen në të ardhmen situatat e evidentuar në raportin e hetimeve të Zyrës së Bashkimit Evropian kundër Mashtrimeve (OLAF), dhe që mbrojnë interesat financiare të BE-së nga aktivitetet ilegale. Për këtë qëllim, do të ngrihet një Komision i Posaçëm Parlamentar, i cili pasi ka analizuar mangësitë, propozon masat konkrete që janë të nevojshme që institucionet përgjegjëse të Bashkimit Evropian të rekomandojnë zhbllokimin e fondeve për Shqipërinë.

5. Shpreh gadishmërinë për të punuar nga afër me institucionet përgjegjëse të Bashkimit Evropian për të mundësuar çdo mekanizëm mbrojtës të nevojshëm për përdorimin me efikasitet dhe në përputhje me Rregullat e Bashkimit Evropian të fondeve financiare të ofruara, me qëllim që të mundësohet vijimi i mbështetjes financiare të projektit IPARD III për qytetarët shqiptarë.

Gjithashtu, në mbështetje të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, propozojmë edhe ngritjen e një **Komisioni të Posaçëm Parlamentar**, i cili të ketë si përgjegjësi analizimin e mangësive, dhe propozimin e masave konkrete ligjore që janë të nevojshme që institucionet përgjegjëse të Bashkimit Evropian të rekomandojnë zhbllokimin e fondeve për Shqipërinë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETËT:

1. Blasforn Nallari
2. Samir Kanihi
3. Egli Cora
4. Xhelal Mzi
5. Jule Radohi

6. Elola Hoti
7. Gazment Berolli